

Shtojca 1

ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI I PRAKTIKËS PROFESIONALE NË FERMË/BIZNESE.

Meqënëse, riorganizimi i programit të studimit, konsiston kryesisht në forcimin e formimit praktik, përmes intergrimit të studimeve me praktikën direkt në fermë/biznes, organizimi dhe zhvillimi i praktikës profesionale përshkruhet me hollësi në këtë shtojcë dhe çështjet kryesore të saj do të jenë pjesë e Rregullores së Praktikave profesionale të këtij programi të riorganizuar.

1.Partnerët për realizimin e praktikës profesionale.

a) Partnerët për realizimin e praktikës profesionale do të jenë:

- Fermat e mëdha dhe të mesme blegtorale;
- Fermat e mëdha dhe të mesme me aktivitet në bujqësi dhe në blegtori;
- Fermat e agroturizmit që kanë aktivitet të lidhur me blegtorinë dhe prodhimet blegtorale;
- Kompanitë e prodhimit të ushqimeve për blegtorinë;
- Kompanitë e grumbullimit, magazinimit dhe vlerësimit të produkteve blegtorale primare;
- Firma që kanë aktivitet në fushën e ndërtimit dhe mekanizimit të fermave blegtorale;
- Institucionet publike qendrore, rajonale dhe lokale të bujqësisë, ekstensionit, zhvillimit rural, sigurisë së produkteve blegtorale primare dhe sigurisë së ushqimeve për blegtorinë;
- Qendra/institucione të transferimit të teknologjisë dhe konsulencës në fushën e blegtorisë dhe sigurisë së produkteve blegtorale primare.

b) Përzgjedhja e fermave/bizneseve për praktikat profesionale – Fermat dhe bizneset në tërësi do të përzgjidhen mbi bazën e të dhënave të madhësisë dhe drejtimit të veprimtarisë ekonomike. Synohet që ato të jenë sa më të shpërndara në gjithë vendin, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të zhvillojnë praktikën profesionale sa më afër vendbanimit të tyre.

c) Institucionalizimi i bashkëpunimit midis universitetit dhe sipërmarrjeve për praktikat profesionale.

c.1.) Zgjerimi i Marrëveshjeve UBT-ferma/biznese/shoqata fermerësh/biznesesh-

Bashkëpunimi dhe kontributi i cdo sipërmarrje private për zhvillimin e praktikave profesionale institucionalizohet me anë të Marrëveshjeve ekzistuese si dhe ato të reja/të përmirësuara a zgjeruara me shoqatat/bashkimet e fermave/biznesve ose sipërmarrjet e vecanta. Marrëveshjet synojnë njohjen e kontributit të sipërmarrjeve si dhe modalitetet që rregullojnë gjithë praktikën e studentëve.

c.2) Bashkëpunimi me përfitim reciprok. Bashkëpunimi i departamentit dhe UBT me sipërmarrjet kontribuese në formimin praktik të studentëve, do të krijoj një ***raport përfitimi reciprok***, përmes marrjes përsipër /ofrimit nga ana e departamentit të disa shërbimeve pa pagesë për fermat/bizneset kontribuese, si trajnimet, këshillime, analiza me tarifa të reduktuara, etj., si dhe përfshirjen e bashkimeve/shoqatave të bizneseve apo edhe bizneseve të mëdha të vecanta në projektet të kërkimit, zhvillimit, transferimit të teknologjisë dhe inovacionit.

d) Promovimi i kontributit të biznesit në realizimin e praktikës profesionale të studentëve. Ky kontribut do të konsiderohet si një kontribut i rëndësishëm social dhe zhvillimor i sipërmarrjeve për mbështetjen e formimit praktik të studentëve, të cilët do të jenë bartës dhe kontribues të zhvillimit të sektorit të blegtorisë në dekadat që vijnë. Prandaj, ai do të promovohet me përparësi nga ana e Universitetit, përmes formave të ndryshme, sic janë:

- Publikimi i *Listës së bizneseve kontribuese* në faqen e internetit të Universitetit dhe në faqen e projektit Erasmus që po implementohet;
- *Bërja e njohur e kontributit të fermave/bizneseve pranë ministrive, institucioneve qendrore, rajonale dhe lokale.*
- **UBT, në kuadër edhe të projektit Erasmus, do të propozoj paketë incentivash për fermat dhe bizneset që kontibudojnë në zhvillimin e praktikave të studentëve.** Mbështetur në përvojën e tij si dhe të përvojave të vendeve të tjera, UBT i propozon institucioneve vendimarrëse një paketë incentivash realiste stimuluese për rritjen e kontributit të fermave/bizneseve për formimin praktik të studentëve në formën e intershipeve dhe praktikave profesionale. P.sh. do të ishte një incentiv i rëndësishëm për fermat dhe bizneset nëse kontributi i tyre në praktikat profesionale të studentëve të UBT do të vlerësohej përmes “pikëve bonus” nga ana e AZHBR në procedurat e vlerësimit për mbështetje financiare përmes fondeve të buxhetit ose ato në kuadër të IPARD-it. Të tillë incentiva mund të aplikohen edhe në aspektet fiskale. Projekti Erasmus në fjalë do të kontibudojë për përgatitjen e propozimeve konkrete, të cilët pasi shqyrtohen dhe miratohen brenda UBT. Autoritetet dhe Organet e UBT i vlerësojnë këto propozime dhe mund t’ia propozojnë ministrive përkatëse/qeverisë për t’i konsideruar, edhe në kuadër të realizimit të objektivit të Strategjisë për ndërlidhjen e arsimit të lartë me tregun e punës (objektivi specifik C3, fq. 91).
- Ngritja e ***Grupit të Partnerëve të Praktikës profesionale*** pranë Departamentit në të cilin bëjnë pjesë përfaqësues të biznesit blegtoral. Ky Grup i shërben Departamentit, Fakultetit dhe UBT për të përmirësuar dhe orientuar më mirë ofertën akademike, në mënyrë të vecantë atë të praktikës profesionale, si dhe për të forcuar bashkëpunimin e Departamentit me biznesin në ofrimin e shërbimeve dhe transferimin e njohurive;

Draft-Strategjia Kombëtare e Arsimit (kreu Arsimit i lartë) 2021-2026 krijon një hapësirë të rëndësishme dhe premtan për një mbështetje nga ana e Qeverisë, si për universitetet ashtu edhe për bizneset, për të zhvilluar një kuadër shumë më të avancuar të bashkëpunimit universitet - partnerë të sektorit të bujqësisë dhe nënsektorëve të saj, si dhe të tregut të punës, për realizimin e praktikave profesionale të studentëve. Në këtë kontekst, duket se Strategjia nuk përjashton edhe mbështetje buxhetore për studentët për praktikat profesionale për periudhë më të gjatë.

Identifikimi i të gjitha fermave/bizneseve të përshtatshme për praktikat profesionale si dhe zhvillimi i gjithë kuadrit të institucionalizimit të bashkëpunimit të Departamentit/Universitetit me to, është një ndër objektivat e projektit Erasmus që mbështet implementimin e programit të riorganizuar. Ky objektivi do të realizohet gjatë këtyre dy viteve, në mënyrë që të filloj normalisht praktika profesionale, faza e parë e së cilës (Praktika 1) fillon në muajin **Maj, 2024**.

e) Shpërndarja e studentëve në ferma/biznese.

Studentët përzgjedhin fermat/bizneset ku do të zhvillojnë praktikën profesionale duke u bazuar në listën e fermave/bizneseve që kanë Marrëveshje me UBT për praktikat profesionale. Ata mund të realizojnë fazat e ndryshme të praktikës në ferma/biznese të ndryshme që i kanë më afër vendbanimit të tyre dhe plotësojnë kushtet për realizimin e programit të fazës përkatëse të praktikës profesionale.

Fermat dhe bizneset private mund të intervistojnë, përzgjedhin si dhe të propozojnë vetë studentët që dëshirojnë të pranojnë për praktikë profesionale. Në rastet kur studenti vjen nga një familje fermere ose që ka një biznes tjetër të lidhur me blegtorinë, ai/ajo mund të kryej të gjitha fazat e praktikës profesionale në fermën/biznesin e familjes.

2. Struktura e praktikës profesionale.

2.1. Objektivat e përgjithshme formuese të praktikës profesionale.

Në kurrikulën e riorganizuar të studimeve të integruara me praktikën, sic thotë edhe vetë emërtimi, qëllimi kryesor është integrimi ose kombinimi i teorisë me praktikën profesionale në fermë/biznes. Kjo u mundëson studentëve që të transferojnë dhe aplikojnë në praktikën e fermave/bizneseve, njohuritë teorike që ata kanë mësuar në pjesën teorike të kurrikulës. Nga ana tjetër, gjatë zhvillimit të mësimeve teorike (leksione apo mësim praktikë), studentëve u krijohet hapësira e mjaftueshme që të sjellin në auditor përvojën që kanë fituar gjatë praktikës profesionale.

Studentët do të kenë mundësi që gjatë praktikës profesionale në fermë/biznes të njihen me organizimin, funksionimin, manaxhimin e përditshëm si dhe shkallën e modernizimit (teknologjia dhe mekanizimi, përdorimi i IT, etj) të një sipërmarrje të madhe ose të mesme në sektorin e blegtorisë dhe t'i analizojnë ato në raportet dhe projektet e praktikës. Më tej, studentët gjatë praktikës profesionale ndjekin nga afër dhe analizojnë në mënyrë të thelluar në projektet e kursit, aspekte të vecanta të fermave dhe bizneseve të sektorit të blegtorisë. Gjithashtu, studentët do të kenë mundësi të zhvillojnë një pjesë të praktikës profesionale edhe në institucionet publike (qendrore, rajonale dhe vendore), që manaxhojnë zhvillimin e blegtorisë dhe sigurinë ushqimore e të ushqimeve për blegtorinë.

2.2. Elementët e praktikës profesionale.

Këto objektiva të praktikës profesionale do të realizohen përmes zhvillimit e strukturimit të saj në dy forma:

- *Praktikë profesionale në fermë/biznese*, gjatë së cilës studentët, sipas programit të praktikës profesionale, të marrë nga departamenti, marrin pjesë në të gjithë proceset e punës dhe të veprimtarisë së fermës/biznesit, duke qenë të atashuar pranë fermerit, stafit teknik apo specialistit/tëve që drejojnë teknikisht biznesin. Për këtë pjesë të praktikës profesionale studentët përgatisin një *Raport të praktikës profesionale* (shih nënkreun: Vlerësimi i praktikës profesionale), mbi bazën e të cilit bëhet edhe vlerësimi i studentit për praktikën profesionale.
- *Thellim në formën e mësimit të pavarur, përmes projekteve të kursit (Project-based Learning), në tema të vecanta profesionale të veprimtarisë prodhuese të fermës/biznesit (Independent learning)*. Përmes kësaj forme të formimit, studentët, thellojnë njohuritë e fituara në pjesën teorike të kurrikulës dhe zhvillojnë aftësitë kyce (skills) për të analizuar, diskutuar dhe vlerësuar

në Projektin e kursit dhe prezantimin e tij, tema ose situata konkrete që hasin direkt në praktikë. Këtë pjesë të praktikës studentët e realizojnë duke u udhëhequr nga pedagogët e departmentit dhe, kur është e mundur, edhe nga stafi teknik i fermës/biznesit ku ata realizojnë praktikën. Për këtë pjesë të praktikës profesionale studentët përgatisin dhe paraqesin në department një *Projekt Kursi (Project Work) dhe një prezantim në PPT* (shih: Vlerësimi i praktikës profesionale).

Të dy format e mësipërme të praktikës profesionale do të zhvillohen në kuadër të projektit Erasmus në fjalë, mbi bazën e përvijës së universiteteve partnere, NGU dhe Savonia AUS. Madje Savonia UAS ka zhvilluar përvijë shumë të mirë edhe për udhëheqjen/konsultimin e studentëve gjatë realizimit të praktikës profesionale, sidomos të Projekte të kursit, përmes aplikimit të gjërë edhe të Distance Learning.

2.3. Shpërndarja e praktikës profesionale gjatë periudhës së studimeve.

Sic u parashtua në nënkreun 1.4.1. (*Krahasimi i kurrikulës së riorganizuar me atë aktuale, sipas viteve të studimit*), praktika profesionale shpërndahet përgjatë të tre viteve të studimeve me qëllim që fazat/modulet e saj të kombinohen në kohë dhe të përputhen në objektivat/përmbajtjen e tyre, me ato të blloqeve të moduleve të pjesës teorike të kurrikulës.

Praktika profesionale e strukturuar në mënyrë të tillë dhe e shpërndarë përgjatë gjithë periudhës së studimeve, u krijon mundësi studentëve, që, gjatë zhvillimit të praktikës profesionale, të përgatisin dhe paraqesin për vlerësim projekte kursi dhe të shkruajnë raporte të praktikës për fermat/bizneset ku ata realizojnë praktikën, cka realizon edhe një transferim të vazhdueshëm dhe integrim të teorisë me praktikën reale gjatë gjithë periudhës së studimeve të integruara me praktikën.

2.4. Përmbajtja e programit të praktikës profesionale.

Për cdo fazë të praktikës profesionale, Departamenti do të hartoj programin e praktikës, i cili do të përmbajë elementët e mëposhtëm në përmbajtjen e tij:

- *Kohëzgjatja dhe periudha kalendarike e realizimit;*
- *Ngarkesa në orë dhe ECTS;*
- *Pedagogët që udhëheqin praktikën;*
- *Përmbledhje e rezultateve të pritshme në formimin praktik;*
- *Objektivat kryesore të praktikës;*
- *Cështjet ose temat kryesore profesionale të praktikës të lidhura me pjesën teorike respektive të kurrikulës;*
- *Rezultatet e praktikës (raporte me shkrim, prezantime);*
- *Forma e vlerësimit të praktikës (pjesëmarrje në praktikë, notë, etc).*

Programi i cdo faze të praktikës konsultohet me studentët paraprakisht gjatë simestrave të mësimave teorike dhe u jepet atyre përpara fillimit të praktikës profesionale.

Në fazat e praktikës profesionale, gjatë të cilave studentët do të zhvillojnë edhe një Projekt Kurs (Project Work), departamenti do të shpall fushat ose grupmodulet të cilat mund të zgjidhen nga studentët për të zhvilluar Projekt kursin. Për cdo fushë apo grupmodulesh të shpallur, pedagogët e departamenti përgatisin *Metodologjinë e Projekt Kursit*, e cila duhet të jetë në formën e një *metodike shumë të hollësishme pune*, mbi bazën së cilës studenti punon, në mënyrë të pavaruar, gjatë praktikës, nën udhëheqjen e pedagogut dhe stafit teknik të fermës/biznesit, ku ai/ajo zhvillon praktikën profesionale.

Metodologjia e Prpjekt Kursit shtjellohet gjërësisht me studentët gjatë zhvillimit të modulit/ grupmoduleve në pjesën teorike të kurrikulës.

2.5. Udhëheqja e studentëve në praktikën profesionale.

Udhëheqja e studentëve për realizimin e praktikës profesionale do të realizohet nga pedagogët e departamentit në bashkëpunim me fermerët dhe stafin teknik të fermës/biznesit kur studenti zhvillon praktikën. Ky bashkëpunim do të jetë i natyrës komplementare dhe të mirëkordinuar.

(i) Udhëheqja e studentëve nga pedagogët.

Për shkak të kushteve/rrethanave aktuale në fermat/bizneset e vendit tonë dhe mungesës së një përvoje të institucionalizuar të „*instruktorëve të praktikës*“, praktika profesionale e studentëve, në kuadër të këtij programi studimi, do të udhëhiqet kryesisht nga pedagogët e departamentit. Ata do të udhëheqin studentët për të dyja format e praktikës. Roli i pedagogëve është akoma më i madh për udhëheqjen e studentëve në zhvillimin e Projekt Kursit gjatë periudhës së praktikës profesionale. Udhëheqja e studentëve nga pedagogët do të realizohet kryesisht Online (Distance Learning) si dhe vizitave në fermë/biznes, kur ato janë të domosdoshme. Projekti Erasmus do të zhvilloj edhe kapacitetet e nevojshme për e-Learning, përfshirë edhe trajnimin e studentëve, pedagogëve, si dhe të personelit teknik të fermave, mbi metodat bashkëkohore didaktike të e-Learning edhe gjatë realizimit të praktikës profesionale, d.m.th. për realizimin e programit të praktikës në format e detyrave të integruara të kursit, projekteve të kursit, etj. Zhvillimi i kapaciteteve për e-Learning do të mbështetet kryesisht në përvojën e Savonia AUS, Finlandë, si partner i projektit Erasmus.

(ii) Mbikqyerja /udhëheqja nga fermeri dhe stafi teknik i fermës/biznesit.

Gjatë kryerjes së praktikës profesionale në ferma/biznese studentët marrin pjesë në të gjithë proceset e punës dhe të veprimtarisë së fermës/biznesit. Kjo realizohet përmes mbikqyerjes dhe udhëheqjes së afërt të studentit nga fermeri dhe stafi teknik që drejton ose konsulton/asiston teknikisht fermën/biznesin. Në vendin tonë nuk ekziston akoma një përvojë e institucionalizuar për udhëheqjen e studentëve, nga ana e fermerëve dhe stafit teknik të fermës/biznesit. Me përvojë të institucionalizuar nënkuptojmë trajnimin e stafit të fermave/bizneseve për të kryer rolin e „*Instruktorit të praktikës*“ për të udhëhequr studentët në praktikën profesionale pranë tyre. Nga ana tjetër, duhet të konsiderojmë edhe faktin që fermat e mesme dhe bizneset me madhësi mesatare nuk kanë staf teknik të punësuar me kohë të plotë. Prandaj ato ftojnë, sipas nevojës që kanë për asistencë, specialistët/ekspertët e drejtorive të bujqësisë dhe të ekstensionit ose ata privat me të cilët mund të kenë raporte shërbimi me kontratë. Një situatë e tillë ndeshet edhe në fermat dhe bizneset e mëdha që kanë specialistë veteriner por jo gjithnjë kanë specialist zooteknik. Gjithashtu, në fermat dhe bizneset në vendin tonë, madje edhe ato të mëdha, fermerët apo administratorët e tyre jo gjithnjë kanë një shkollim profesional adekuat, të mesëm profesional bujqësor, aq më pak arsim të lartë në fushën e bujqësisë. Prandaj, projekti Erasmus që po implementohet, patrashikon edhe trajnim të personelit teknik të fermave/bizneseve për udhëheqjen e studentëve në praktikën profesionale.

Raporti i udhëheqjes praktike të studentëve nga stafi teknik i fermës/biznesit dhe asaj nga stafi akademik i UBT duhet të jetë, sic u tha më sipër, komplementar dhe i mirëkoordinuar. Ne presim që, me zhvillimin e traninimit të stafeve teknike të fermave/bizneseve, të rritet dora dorës roli i fermerëve dhe

stafeve teknike të fermave/bizneseve në udhëheqjen praktike të studentëve. Por, ne jemi të vetdijshëm, që ky proces „*transferimi*“ ose „*zhvendosjeje*“ i kompetencës së udhëheqjes nga stafi akademik i universitetit tek stafi teknik i fermave/bizneseve, kërkon kohë, dhe, sigurisht, incentiva stimuluese për stafin e fermave/bizneseve. Pra ky është një ***process zhvillimi (së paku) afatmesëm***, për të cilin kontribon edhe projekti Erasmus në fjalë.

2.6. Vlerësimi i volumit të ngarkesës mësimore/formuese të praktikës profesionale.

Volumi i ngarkesës mësimore/formuese gjatë praktikës profesionale do të vlerësohet me Kreditet e formimit ECTS. Këto janë kredite të formimit praktik. Meqënëse kuadri ynë ligjor dhe nënligjor nuk ka asnjë përcaktim të vecantë për vlerësimin e praktikës profesionale, të ndryshëm nga ai i përgjithshëm për volumin e punës mësimore të një programi studimi, ne do të aplikojmë kriteret që parashikon ky kuadër rregullator në fuqi.

Për 1 ECTS do të llogariten 25 orë praktikë profesionale në fermë/biznes (**1 ECTS=25 orë**).

Për një ditë praktikë profesionale do të llogariten 5 orë praktikë në fermë/biznes ose 25 orë në javë.

Mbi bazën e kriterëve të mësipërme dhe kohëzgjatjes së cdo faze/moduli të praktikës profesionale llogaritet numri total i ECTS të formimit praktik.

2.7. Vlerësimi rezultateve të praktikës profesionale.

Rezultatet e praktikës profesionale janë:

- (i) *Raporti i praktikës profesionale*, në të cilin studenti përshkruan dhe analizon çështjet e parashikuara në programin e praktikës për fermën/biznesin ku zhvillon atë. Ai vlerësohet mbi bazën e raportit të paraqitur ose edhe me anë të prezantimit. Kjo do të përcaktohet në programin për cdo fazë të praktikës.
- (ii) *Projekt Kursi (Project Work)*, në të cilin studenti realizon programin e parashikuar në temën/fushën e parashikuar në projektin në fjalë. Ai vlerësohet me notë mbi bazën e materialit të shkruar (Raporti i Projektit) të paraqitur si dhe prezantimit të tij.

Forma e vlerësimit dhe raporti midis rezultateve (raporte, prezantime) të praktikës përcaktohen për cdo fazë të praktikës profesionale.

3. Karakteristikat kryesore të praktikës profesionale sipas viteve të studimeve.

3.1. Moduli “Praktika 1” – karakteristikat bazë

- *Objektivat kryesore të praktikës* – Objektivi kryesor i Praktikës 1 është është njohja e organizimit, funksionimit dhe veprimtarisë prodhuese të një ferme/biznesi në fushën e blegtorisë dhe nënsektorët e lidhur me të. Përmes Praktikës 1 studentët kanë mundësi të aplikojnë dijet teorike të fituara në vitin e dytë të studimeve dhe që përshkruhen në programin e praktikës profesionale Praktika 1. Përvec programit të praktikës profesionale Praktika 1, studentët do të realizojnë gjatë kohës së praktikës edhe një Projekt Kurs (Project Ėork), sipas një Metodologjie të Projektit të Kursit që do të marrin nga departamenti.

- *Kohëzgjatja dhe periudha kalendarike e realizimit* - Praktika 1 është praktika profesionale që do të zhvillohet pas përfundimit të ciklit të mësimave teorike të vitit të dytë akademik. Ajo do të zgjasë rreth 10 javë, gjatë periudhës 15.05. deri 30.07. të vitit kalendarik përkatës.
- *Ferma/biznesi ku zhvillohet*: Praktika 1 mund të zhvillohet në cdo fermë të madhe apo të mesme apo biznes i madh (p.sh. fabrikat dhe apo i mesëm i fushës së blegtorisë) dhe nënsektorëve të tjerë të lidhur me blegtorinë, sipas listës së fermave/biznesve që kanë marrëveshje me UBT për praktikën profesionale të studentëve.
- *Ngarkesa në orë dhe ECTS* - Praktika 1 parashikon 5 orë/ditë ose 25 orë/javë praktikë profesionale në fermë/biznes. Volumi i ngarkesës mësimore praktike do të jetë 10 ECTS dhe do të evidentohet në Listën e moduleve si “Moduli praktik – Praktika 1”.
- *Cështjet ose temat kryesore profesionale të praktikës*- Cështjet ose temat kryesore profesionale të praktikës 1 orientohen nga modulet kryesore që zhvillohen në pjesën teorike të kurrikulës në vitin e dytë të studimeve Bachelor, në shkencat zooteknike bazë, kryesisht në të ushqyerit dhe ushqimet e kafshëve, higjenën dhe sëmundjet kryesore të kafshëve, sistemet e mbajtjes, mekanizimi dhe ndërtimet në blegtori, drejtimi i fermave, metodat e komunikimit dhe këshillimit në blegtori, si dhe të agroekologjisë e mjedisit. Gjatë periudhës së praktikës 1 studentët, sipas programit të praktikës të marrë nga departamenti, marrin pjesë në të gjithë proceset e punës dhe të veprimtarisë së fermës/biznesit në fushën e blegtorisë apo nënsektorë të lidhur ngushtë me të, duke qenë të atashuar pranë fermerit, stafit teknik apo specialistit/tëve që drejojnë/asistojnë teknikisht biznesin.

Përveç programit të praktikës 1, studentët realizojnë gjatë saj, në mënyrë të pavaruar, edhe një Projekt Kursi. Përmes këtij Projekt Kursi (Projekt Work) studentët thellojnë dhe aplikojnë në praktikë, në formën e mësimit të pavarur (Independent learning), njohuritë teorike të fituara kryesisht në fushat e mëposhtme:

- Të ushqyerit dhe ushqimet e kafshëve;
- Higjena dhe sëmundjet kryesore të kafshëve;
- Sistemet e mbajtjes, mekanizimi dhe ndërtimet në blegtori;
- Politikat e zhvillimit & këshillimi në sektorin e blegtorisë;
- Agroekologjia dhe ndikimet e blegtorisë në mjedis;
- Ekonomia e prodhimit blegtoral.

Cdo student zgjedh një nga fushat e sipër përmendura, të cilat shpallen nga departamenti dhe për secilën prej tyre studentëve u afrohet një Metodologji e Projekt Kursit në formën e një metodike të hollësishme pune mbi bazën e së cilës studenti zhvillon Projektin e Kursit.

- *Rezultatet e praktikës* – Rezultatet e praktikës 1 do të jenë si më poshtë:
 - (i) *Raportit të praktikës* (15-20 faqe), i cili përshkruan dhe analizon organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë prodhuese të fermës/biznesit ku studenti ka realizuar praktikën;
 - (ii) *Projekti Kursi*, i cili duhet të jetë 25-30 faqe;
 - (iii) *Prezantim PPT*, i përgatitur mbi bazën e Projekt Kursit, 15 -20 minuta.
- *Forma e vlerësimit të praktikës*:
 - Raporti i praktikës 1 dorëzohet në departament dhe vlerësohet pa notë si detyrim i shlyer.

- *Projekti Kursi*, mbrohet para pedagogëve të grupmoduleve dhe vlerësohet me notë (75 % e vlerësimit të Projekt kursit).
- *Prezantim PPT*, referohet para pedagogëve të grupmoduleve dhe vlerësohet me notë (25 % e vlerësimit të Projekt kursit).

3.2. *Praktika 2 – karakteristikat bazë*

- *Objektivat kryesore të praktikës* - Objektivi kryesor i Praktikës 4 është njohja e organizimit, funksionimit dhe veprimtarisë së institucioneve publike, qendrore, rajonale dhe vendore (pranë bashkive) të sektorit të bujqësisë (agjenci qendrore, drejtori rajonale të bujqësisë dhe zhvillimit rural; agjenci/njësi të Shërbimit këshillimor; drejtori/njësi/inspektoriate/laboratorë të sigurisë së ushqimeve shtazore dhe ushqimeve për blegtorinë, etj.), të cilët drejtojnë dhe manaxhojnë zhvillimin e blegtorisë, sigurinë e ushqimore shtazore si dhe të ushqimeve për blegtorinë, dhe nënsektorë të tjerë të lidhur me blegtorinë.
Përmes Praktikës 2 studentët kanë mundësi të vazhdojnë të aplikojnë dijet teorike të fituara në vitin e dytë të studimeve dhe njëherazi të marrin pjesë dhe të njohin nga afër procese dhe aspektet të fermës/biznesit që lidhen me dijet që do të afrohen në vitin e tretë akademik.
- *Kohëzgjatja dhe periudha kalendarike e realizimit* - Praktika 2 është praktika profesionale që do të zhvillohet përpara fillimit të ciklit të mësimave teorike të vitit të tretë akademik, zgjat 4 javë dhe zhvillohet nga 15.9. deri 15.10. të vitit kalendarik përkatës.
- *Institucioni ku zhvillohet:* Praktika 2 mund të zhvillohet në cdo institucion qendror, rajonal ose vendor që vepron në fushën e sipërpërmendur në paragrafin e parë të këtij nënkreu dhe që kanë marrëveshje me UBT për praktikat profesionale të studentëve.
- *Ngarkesa në orë dhe ECTS* - Praktika 2 parashikon 5 orë/ditë ose 25 orë/javë praktikë profesionale në një institucion publik. Volumi i ngarkesës mësimore praktike do të jetë 4 ECTS dhe evidentohet në listën e moduleve të diplomës dhe suplementit të saj si “*Moduli praktik – Praktika 2*”.
- *Cështjet ose temat kryesore profesionale të praktikës*- Cështjet ose temat kryesore profesionale të praktikës 2 orientohen nga modulet kryesore që janë zhvilluar në pjesën teorike të kurrikulës në dy vitet e para të studimeve Bachelor, në mënyrë të vecantë, në këndvështrimin e politikave të zhvillimit, praktikave të administrimit të sektorit, praktikave të mbështetjes e këshillimit të fermave dhe biznesve të sektorit të blegtorisë, si dhe ato të mbikqyrjes dhe inspektimit të këtij sektori dhe të sigurisë së produkteve blegtorale primare dhe të ushqimeve për blegtorinë. Gjatë periudhës së praktikës 2 studentët, sipas programit të praktikës të marrë nga departamenti, marrin pjesë në të gjithë proceset e punës dhe të veprimtarisë së institucionit publik, duke qenë të atashuar pranë specialistëve të tij.
- *Rezultatet e praktikës* – Rezultati i praktikës 2 do të jetë një *Raport i praktikës*, i cili përshkruan dhe analizon organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë prodhuese të fermës/biznesit ku studenti ka realizuar praktikën.
- *Forma e vlerësimit të praktikës* – Raporti i praktikës 2 do të dorëzohet në departament, do të perzantohet dhe do të vlerësohet me notë.

3.3. *Praktika 3 – karakteristikat bazë*

- *Objektivat kryesore të praktikës* – Objektivi kryesor i Praktikës 3 është njohja e organizimit, funksionimit, veprimtarisë prodhuese dhe e të gjithë hallkave të manaxhimit zooteknik dhe ekonomik të një ferme/biznesi në fushën e blegtorisë. Përmes Praktikës 3 studentët kanë mundësi të aplikojnë dijet teorike të fituara në të tre vitet e studimeve, por sidomos ato të vitin të tretë akademik. Përveç programit të praktikës profesionale Praktika 3, studentët do të realizojnë gjatë kësaj kohe edhe një Projekt Kurs sipas një Metodologjie të Projektit të Kursit që do të marrin nga departamenti.
- *Kohëzgjatja dhe periudha kalendarike e realizimit* - Praktika 3 është praktika profesionale që do të zhvillohet pas përfundimit të ciklit të mësimave teorike të simestrit V. Ajo zë gjithë simestrin VI dhe vazhdon deri në 30.07. të vitit kalendarik përkatës (gjithsej 20 javë).
- *Ferma/biznesi ku zhvillohet*: Praktika 3 mund të zhvillohet në cdo fermë të madhe apo të mesme apo biznes i madh apo i mesëm i fushës së blegtorisë dhe nënsektorëve të tjerë të lidhur me blegtorinë, sipas listës së fermave/biznesve që kanë marrëveshje me UBT për praktikën profesionale të studentëve. Synohet që studentët të kryejnë praktikën profesionale “Praktika 3” jo në të njëjtën fermë ku kanë kryer “Praktikën 1”, në mënyrë që të kenë mundësi të fitojnë përvojë në më shumë specie d.m.th. lloje të fermave blegtorale. Në funksion të këtij qëllimi, nëse do të jetë e mundur, mund të ndahet edhe periudha e “Praktikës 3” dhe të kryhet në dy lloje fermash blegtorale. Ky alternativë është potencialisht i mundur për shkak të numrit të kufizuar të studentëve (rreth 25 studentë) që do të pranohen në këtë program. Megjithatë, kjo do të varet nga shpërndarja rajonale e fermave blegtorale të mesme dhe të vogla dhe mundësia e aksesit të studentëve për shkak të vendbanimit të tyre.
- *Ngarkesa në orë dhe ECTS* - Praktika 3 parashikon 5 orë/ditë ose 25 orë/javë praktikë profesionale në fermë/biznes. Volumi i ngarkesës mësimore praktike do të jetë 18 ECTS dhe do të evidentohet në Listën e moduleve si “Moduli praktik – Praktika 3”.
- *Cështjet ose temat kryesore profesionale të praktikës*- Cështjet ose temat kryesore profesionale të praktikës 3 orientohen nga modulet kryesore që zhvillohen në pjesën teorike të kurrikulës në vitin e tretë të studimeve Bachelor, në shkencat zooteknike të aplikuara, kryesisht në mbarështimin dhe manaxhimin e fermave të specieve të vecanta të kafshëve (gjedhi, dhentë, dhitë, derrat, njëthundrakët), shpendëve dhe bletës.
Gjatë periudhës së praktikës 3 studentët, sipas programit të praktikës të marrë nga departamenti, marrin pjesë në të gjithë proceset e punës dhe të veprimtarisë së fermës/biznesit në fushën e blegtorisë apo nënsektorë të lidhur ngushtë me të, duke qenë të atashuar pranë fermerit, stafit teknik që drejton teknikisht biznesin.

Përveç programit të praktikës 3, studentët realizojnë gjatë saj, në mënyrë të pavaruar, edhe një Projekt Kursi. Përmes këtij Projekt Kursi (Projekt Work) studentët thellojnë dhe aplikojnë në praktikë, në formën e mësimit të pavarur (Project-based Learning ose Independent learning), njohuritë teorike të fituara në disiplinat e specieve të vecanta të kafshëve dhe shpendëve kryesisht në fushat e mëposhtme:

- teknologjitë e të ushqyerit në fermat e specieve të vecanta;
- përmirësimi gjenetik dhe riprodhimi në fermat e specieve të vecanta;
- higjena, sistemet e mbajtjes dhe mirëqenia e kafshëve në fermat e specieve të vecanta;
- siguria në fermë, cilësia dhe siguria e produkteve blegtorale primare;

- riprodhimi dhe inseminimi artificial i kafshëve bujqësore;
- ekonomia dhe konkurrueshmëria e fermës.

Të gjitha këto aspekte mund të emërtohen si “Manaxhim i integruar (zooteknik dhe ekonomik) i fermës blegtorale”, cka nënkupton një sintezë të të gjitha njohurive që ka marrë studenti duke u fokusuar në një specie, për të cilën ai/ajo ka përzgjedhur të zhvilloj Projektin e Kursit, nën udhëheqjen e pedagogëve të departamentit.

- *Rezultatet e praktikës* – Rezultatet e praktikës 3 do të jenë si më poshtë:
 - (i) *Raportit të praktikës* (15 - 20 faqe), i cili përshkruan dhe analizon mbarështimin dhe manaxhimin e fermës blegtorale ku studenti ka realizuar praktikën;
 - (ii) *Projekti Kursi*, i cili duhet të jetë 25-30 faqe;
 - (iii) *Prezantim PPT*, i përgatitur mbi bazën e Projekt Kursit, 15 -20 minuta.
- *Forma e vlerësimit të praktikës:*
 - Raporti i praktikës 3 dorëzohet në departament dhe vlerësohet pa notë si detyrim i shlyer.
 - *Projekti Kursi*, mbrohet para një komisioni dhe vlerësohet me notë (75 % e vlerësimit të Projekt kursit).
 - *Prezantim PPT*, referohet para komisionit dhe vlerësohet me notë (25 % e vlerësimit të Projekt kursit).

3.4.Projekti ose mikroteza e studimeve Bachelor

Përveç programit të praktikës 3, studentët realizojnë gjatë saj, direkt në fermë, edhe Projektin ose Mikrotezën Bachelor, përmes së cilës studentët thellojnë dhe aplikojnë në praktikë, njohuritë teorike të fituara në disiplinat e zhvilluara gjatë gjithë studimeve Bachelor. Ky projekt finalizohet me një mikrotezë, e cila përfaqëson edhe punën e parë me elementë kërkimorë që realizon studenti në studimet universitare Bachelor. Departamenti shpall që në fillim të vitit të tretë të studimeve temat e Bachelorit dhe pedagogët udhëheqës shkencor. Cdo student përzgjedh një prej këtyre temave. Projekti Bachelor mund të jetë edhe një projekt i një grup prej maksimumi 4 studentë, por secili student shkruan mikrotezën e tij për aspektet e vecanta të projektit që ka ndjekur dhe studjuar ai/ajo.

- *Rezultati:*
 - (i) *Mikroteza Bachelor*, e cila duhet të jetë 30-35 faqe;
 - (ii) *Prezantim PPT*, i përgatitur mbi bazën e Mikrotezës, 15 -20 minuta.
- *Forma e vlerësimit të rezultateve të praktikës:*
 - *Mikroteza Bachelor*, mbrohet para një komisioni dhe vlerësohet me notë (75 % e vlerësimit të Projekt kursit).
 - *Prezantim PPT*, referohet para komisionit dhe vlerësohet me notë (25 % e vlerësimit të Projekt kursit).